



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**RAPORTI RREGULLATIV**  
**Përcaktimi i tarifave për Ndrohtoren e Qytetit Gjakova SH.A.Sezoni i Ndrohjes**  
**2023/2024**  
***/draft për konsultim publik/***

***Prishtinë, nëntor 2023***



## 1. Hyrje – Struktura Tarifore

Struktura tarifore për energjinë termike është përcaktuar në përputhje me Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike të nxjerrë nga ZRRE (Kapitulli IV: Tarifave të energjisë termike – nenet 15 dhe 16). Struktura e tarifave të energjisë termike përmban 2 lloje të tarifave: Tarifave për 'konsumatorët me matje' dhe tarifave për 'konsumatorët pa matje', varësisht nga Infrastruktura e matësve (njehsorëve) të energjisë termike.

### 1.1 Tarifave për 'konsumatorët me matje'

Tarifave për 'konsumatorët me matje' janë të bazuara në konsumin e matur dhe të regjistruar të energjisë termike. 'Tarifave me matje' përbëhen nga:

- Komponenti fiks i tarifës: ngarkesa mujore e kapacitetit bazuar në kapacitetin e vlerësuar të ngrohjes [€/kW për muaj]; dhe
- Komponenti variabil i tarifës: ngarkesa mujore e energjisë bazuar në furnizimin e matur me ngrohje [€/MWh apo €cent/kWh];

### 1.2 Tarifave për 'konsumatorët pa-matje'

Tarifave për 'konsumatorët pa-matje' bazohen në sipërfaqen e hapësirës së ngrohur të konsumatorëve. Duke marrë parasysh se vlerat e parallogaritura për kapacitetin dhe konsumin specifik të energjisë termike për metër katrorë janë të ndryshme për Konsumatorët Shtëpiak dhe ata Komercial e Institucional, për këtë, me qëllim që tarifave të reflektojnë strukturën specifike të konsumit për secilën kategori, 'tarifave pa-matje' ndahen në dy nën-grupe:

- Tarifave për konsumatorët shtëpiak; dhe
- Tarifave për konsumatorët komercial e Institucional.

Më tutje, 'tarifave pa-matje' kategorizohen në dy komponentë:

- Komponenti fiks i tarifës: ngarkesa mujore e kapacitetit bazuar në një vlerë të përafërt për kapacitetin të ngrohjes për metër katror të hapësirës për ngrohje [€/m<sup>2</sup> për muaj]; dhe
- Komponenti variabil i tarifës: pagesa mujore e energjisë bazuar në një vlerë të përafërt për konsumin të ngrohjes për metër katror të sipërfaqes ngrohëse [€/m<sup>2</sup> për muaj].

## 2. Alokimi i të Hyrave të Lejuara (HML)

Duke ju referuar Shtojcës 6: "Detajet për Llogaritjen e Tarifave" të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, si dhe për të reflektuar strukturën tarifore, për llogaritjen e tarifave të energjisë termike duhet të përcaktohet alokimi i të Hyrave të Lejuara dhe Përcaktuesit e Faturimit.

Alokimi i të Hyrave të lejuara bëhet konform strukturës tarifore, të përshkruar në pikën '1' më lartë, me pikë fillestare të Hyrave të Lejuara, siç janë përcaktuar në Raportin për të Hyrave të Lejuara për NQ Gjakova për sezonin e ngrohjes 2023/24, në vlerë prej 1,001,989 €. Kriter themelorë për alokimin është konsumi i përlllogaritur i energjisë termike për secilën kategori/komponentë tarifore. Bazuar në këtë kriter dhe kategoritë / komponentët e strukturës tarifore, janë përcaktuar koeficientët e alokimit dhe alokimi respektiv i të Hyrave të Lejuara; detajet në vijim:

- Alokimi i HML për tarifave të 'Konsumatorëve me-matje' dhe 'pa-matje' – Për shkak që NQ Gjakova është në vitet e para të operimit, dhe NQ Gjakova nuk ka dorëzuar të dhëna rreth konsumatorëve të cilët parashihen të faturohen me-matje. Në mungesë të të dhënave, nuk bëhet ndarja e HML për konsumatorë me matje dhe pa matje. Tarifave për të dy grupet llogariten duke marrë parasysh HML totale. Konkretisht kalkulimi i tarifave me matje është bërë duke supozuar që të gjithë konsumatorët faturohen me matje, pra energjia termike dhe kapaciteti termik i tërësishëm merret si bazë për



llogaritje; kalkulimi i tarifave pa matje është bërë duke supozuar që të gjithë konsumatorët faturohen pa matje, pra si bazë për llogaritje merret sipërfaqja totale ngrohëse e konsumatorëve.

## 2.1. Alokimi i HML për tarifave pa matje

- Alokimi i HML në komponentën Fikse dhe Variable për tarifave pa matje:

- i) Pjesa fikse e të Hyrave të Lejuara  $HML_{F(pa-matje)} = 492,760 \text{ €}$  dhe
- ii) Pjesa variable e të Hyrave të Lejuara  $HML_{V(pa-matje)} = 509,229 \text{ €};$

- Alokimi i pjesës fikse për konsumatorë shtëpiak dhe konsumatorëve komercial dhe industrial:

Alokimi i pjesës fikse për konsumatorë shtëpiak dhe konsumatorë komercial dhe industrial bazohet në raportin e kapacitetit të angazhuar të kategorisë së konsumatorëve me kapacitetin total të angazhuar. Kalkulimi i kapacitetit të angazhuar është paraqitur në Tabelën 1.

**Tabela 1: Kalkulimi i kapacitetit të angazhuar te konsumatorët shtëpiak dhe konsumatorët komercial dhe industrial.**

	Njësia	Shtëpiak	Komercial dhe industrial	Total
<b>HD<sub>i</sub></b> – Kërkesa e sezonit të ngrohjes të grupit të konsumatorëve ‘i’	MWh	4,950	11,413	16,363
<b>HS<sub>i</sub></b> – Sipërfaqja e ngrohur e grupit të konsumatorëve ‘i’	m <sup>2</sup>	49,502	95,103	144,605
<b>HP<sub>i</sub></b> – Kapaciteti i angazhuar për grupin e konsumatorëve ‘i’	MW	5.21	17.56	22.77
<b>HP<sub>i</sub> / ΣHP</b> – Alokimi i kostove fikse		<b>22.89%</b>	<b>77.11%</b>	<b>100%</b>

- i) Pjesa fikse e HML e alokuar për konsumatorë shtëpiak  $HML_{F SH} = 112,773 \text{ €}$  dhe
- ii) Pjesa fikse e HML e alokuar për konsumatorë kom. dhe ind.  $HML_{F K\&I} = 379,987 \text{ €}$

- Alokimi i pjesës variable për konsumatorë shtëpiak dhe konsumatorëve komercial dhe industrial:

Alokimi i pjesës variable për konsumatorë shtëpiak dhe konsumatorë komercial dhe industrial bazohet në raportin e kërkesës për energji të kategorisë së konsumatorëve me kërkesën total për ngrohje. Alokimi i kostove variable për ngrohje është paraqitur në Tabelën 2.

**Tabela 2: Alokimi i kostove variable për konsumatorë shtëpiak dhe konsumatorë komercial dhe industrial.**

	Njësia	Shtëpiak	Komercial dhe industrial	Total
<b>HD<sub>i</sub></b> – Kërkesa e sezonit të ngrohjes të grupit të konsumatorëve ‘i’	MWh	4,950	11,412	16,363
<b>HDI/ΣHD</b> – Alokimi i kostove variable	Njësia	<b>30.25%</b>	<b>69.75%</b>	<b>100%</b>

- i) Pjesa fikse e HML e alokuar për konsumatorë shtëpiak  $HML_{V SH} = 154,058 \text{ €}$  dhe
- ii) Pjesa fikse e HML e alokuar për konsumatorë kom. dhe ind.  $HML_{V K\&I} = 355,171 \text{ €}$



## 2.2. Alokimi i HML për tarifatat me matje

- Alokimi i HML në komponentën Fikse dhe Variabile për tarifatat pa matje:

Sipas nenit 47, paragrafi 3.9. të Ligjit për Rregulltorin e Energjisë (Nr. 05/L-084), Rregullatori inkurajohet të përdorë mekanizma të ndryshme gjatë përcaktimit të tarifave, për përmirësimin e efijencës së energjisë dhe menaxhimi i kërkesës.

Për të inkurajuar shfrytëzimin efijent të ngrohjes nga konsumatorët me matje, Rregullatori propozon të alokoj HML komponentën variabile dhe fikse të tarifave sipas ndarjes së paraqitur më poshtë.

- i) Pjesa fikse e të Hyrave të Lejuara **HML<sub>F(matje)</sub> = 100,219 €** dhe
- ii) Pjesa variabile e të Hyrave të Lejuara **HML<sub>V(matje)</sub> = 891,770 €;**

## 3. Përcaktuesit e Faturimit

Sikur alokimi i të Hyrave të Lejuara, edhe përcaktuesit e faturimit reflektojnë dhe janë në pajtim me strukturën tarifore; detajet në vijim:

- Për tarifatat pa matje

- i) Sipërfaqja ngrohëse e konsumatorëve shtëpiak: **S<sub>SH</sub> = 49,502 m<sup>2</sup>** dhe
- ii) Sipërfaqja ngrohëse e konsumatorëve komercial e Institucional: **S<sub>K&I</sub> = 95,103 m<sup>2</sup>**

- Për tarifatat me matje

- i) Konsumi total i konsumatorëve: **ΣHD = 16,363 MWh**
- ii) Kapaciteti i angazhuar për të gjithë konsumatorët: **ΣHP = 22.77 MW**

## 4. Nivelet e Tarifave të Energjisë Termike

Në pajtim me strukturën tarifore, si dhe bazuar në alokimin e të Hyrave të Lejuara dhe përcaktuesit e faturimit, llogariten nivelet e tarifave për secilën kategori / komponentë tarifore, siç paraqiten në tabelën vijuese:

**Tabela 3: Struktura dhe nivelet e tarifave të energjisë termike për NQ Gjakova për sezonin 2023/2024:**

Simboli/Poz.	Përshkrimi	Njësia	Vlera		
			Gr. Kons. Shtëpiak	Gr. Kons. Kom. Inst.	Total / Mesatare
MAR <sub>(pa matje)</sub>	Të Hyrat Maksimale të Lejuara për tarifatat pa matje	€			1,001,989
MAR <sub>F(pa matje)</sub>	Pjesa fikse e MAR për tarifatat pa matje	€			492,760
MAR <sub>V(pa matje)</sub>	Pjesa variabile e MAR për tarifatat pa matje	€			509,228
S <sub>(pa matje)</sub>	Sipërfaqja ngrohëse e Kons. pa matje	m <sup>2</sup>	49,502	95,103	144,605
T <sub>yHC</sub>	Tarifa Sezonalë për Kapacitetin Termik (Komp. Fikse)	€/m <sup>2</sup> /sezonë	2.28	4.00	3.41
T <sub>yHD</sub>	Tarifa Sezonalë për Sasinë e furnizuar të En. Term. (Komp. Var.)	€/m <sup>2</sup> /sezonë	3.11	3.73	3.52
T <sub>mHC</sub>	Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (Komp. Fikse)	€/m <sup>2</sup> /muaj	0.38	0.67	0.57
T <sub>mHD</sub>	Tarifa Mujore për Sasinë e furnizuar të En. Term. (Komp. Var.)	€/m <sup>2</sup> /muaj	0.52	0.62	0.59
T <sub>total</sub>	<b>Totali i tarifës mujore pa matje</b>	<b>€/m<sup>2</sup>/muaj</b>	<b>0.90</b>	<b>1.29</b>	<b>1.15</b>
T <sub>F(me matje)</sub>	<b>Tarifa fikse për konsumatorët me matje</b>	<b>€/kW</b>	<b>0.81</b>	<b>0.81</b>	<b>0.81</b>
T <sub>V(me matje)</sub>	<b>Tarifa variabile për konsumatorët me matje</b>	<b>€/MWh</b>	<b>54.50</b>	<b>54.50</b>	<b>54.50</b>

